



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR MIRATIMIN E FLETËS TIP SIPAS KËRKESËS SË INSTITUTIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E SISTEMIT TË ZGJEDHJEVE, PËR NISMËN LIGJVËNËSE TË ZGJEDHËSVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, PËR PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT "PËR REFERENDUMET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 30.06.2020, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për miratimin e fletës tip sipas kërkesës së Institutit Shqiptar për Zhvillimin e sistemit të zgjedhjeve, për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë", për propozimin e projektligjit "Për referendumet në Republikën e Shqipërisë".

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 6, pika 4, neni 10 pika 1, 2 dhe 3 e ligjit nr.54/2019 "Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve;

**V Ë R E N**

Në datë 12.06.2020, Komiteti Përfaqësues i nismës ligjvënëse z. Kristaq Kume, znj. Brisida Gjikondi dhe znj. Eneda Bozheku kanë paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën nr.1187 prot, datë 12.03.2020 për pajisje me fletë tip për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë për propozimin e projektligjit "Për Referendumet në Republikën e Shqipërisë". Bashkëlidhur kërkesës komiteti përfaqësues ka depozituar:



**Nr. 11 i vendimit Data 30.06.2020 e vendimit Ora 11:00 e vendimit**

Për miratimin e fletës tip sipas kërkesës së Institutit Shqiptar për Zhvillimin e sistemit të zgjedhjeve, për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë" për propozimin e projektligjit "Për referendumet në Republikën e Shqipërisë".

- Vërtetimin, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e datës 21.02.2020, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.2672, datë 22.09.1999 ka regjistruar si person juridik Fondacioni "Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve" (INSIZ) me themelues z.Kristaq Kume.
- Kopje të kartës së identiteti për të tre përfaqësuesit e nismës.

Projekt ligji sipas Komitetit Përfaqësues, është rezultat i një pune të gjatë konsultuese me ekspertë, grupe qytetarësh, të zgjedhur vendorë dhe stafe akademike në universitetet e vendin. Janë konsultuar përvojat legjislative të vendeve të ndryshme që e kanë funksionale demokracinë e drejtpërdrejtë. Në të janë pasqyruar kërkesat dhe standardet e parashikuara në dokumentet ndërkombëtare që trajtojnë çështjet e të drejtës për referendum.

Kërkesën e tyre përfaqësuesit e nismës ligjvënëse e bëjnë në mbështetje të nenit 6, pika 4, neni 10 pika 1 e ligjit nr.54/2019 "Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë".

Në mbështetje të nenit 10 pika 2 të ligjit nr.54/2019 "Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë", KQZ, duhet të pajis përfaqësuesit e nismës me fletën-tip, për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme. Referuar nenit 10 pika 3 të ligjit të sipërcituar, fleta tip e mbledhjes së nënshkrimeve, në njërin duhet të përmbajë informacionin mbi nismën ligjvënëse që do ti propozohet Kuvendit, qëllimin dhe një shpjegim të përmbledhur të saj si dhe të dhëna për përfaqësinë / komitetin përfaqësues të nismës ndërsa në anën tjetër duhet të përmbajë; numrin rendor, gjenealitetet e zgjedhësit që mbështet nismën, vendin e datën e lindjes, numrin e kartës së identitetit apo pasaportës së zgjedhësit, kolonën për nënshkrimet e zgjedhësve si dhe hapësirën përkatëse për emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të grupit të mbledhjes së nënshkrimeve.

Referuar nenit 13 pika 1 e ligjit nr.54/2019 "Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë", KQZ, brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës me shkrim të përfaqësisë/komitetit përfaqësues të nismës për pajisjen me fletët tip për mbledhjen e nënshkrimeve, përcakton me vendim, sipas propozimit të përfaqësisë/komitetit përfaqësues, periudhën kohore gjatë të cilës zhvillohet procesi i mbledhjes së nënshkrimeve, në vendet publike dhe private, si dhe nënshkrimeve elektronike. Referuar kërkesës, periudha për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve të kësaj nisme ligjvënëse, do të jetë jo më e gjatë se 3 (tre) muaj nga data e hyrjes në fuqi të vendimit.

Kërkesa e komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse përmban, informacionin mbi nismën ligjvënëse që do ti propozohet Kuvendit, qëllimin dhe shpjegimin në mënyrë të përmbledhur të saj si dhe të dhënat e komitetit përfaqësues të nismës.



**Nr. 11 i vendimit Data 30.06.2020 e vendimit Ora 11:00 e vendimit**

Për miratimin e fletës tip sipas kërkesës së Institutit Shqiptar për Zhvillimin e sistemit të zgjedhjeve, për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë" për propozimin e projektligjit "Për referendimet në Republikën e Shqipërisë".

## **PËR KËTË ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 6, pika 4, neni 10 pika 1, 2 dhe 3 e ligjit nr.54/2019 "Për nismën ligjvënese të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë".

## **V E N D O S I:**

1. Miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Procedura për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve të bëhet brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
3. Publikimin e fletës tip në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 11 i vendimit Data 30.06.2020 e vendimit Ora 11:00 e vendimit**

Për miratimin e fletës tip sipas kërkesës së Institutit Shqiptar për Zhvillimin e sistemit të zgjedhjeve, për nismën ligjvënese të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë" për propozimin e projektligjit "Për referendumet në Republikën e Shqipërisë".